

LAHUTARËT E SANXHAKUT TË PAZARIT TË RI

“Lahutarët e Sanxhakut të Pazarit të Ri”, simpoziium shkencor, i mbajtur më 8 shtator 2018, kryeredaktoi dhe përgatiti për shtyp prof. dr. Zymer Ujkan Neziri, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2020 dhe shoqata “Kosova për Sanxhakun”, 344 f.



Simpoziumi shkencor “Lahutarët e Sanxhakut të Pazarit të Ri”, i mbajtur më 8 shtator 2018, në Institutin Albanologjik të Prishtinës, tuboi studiues nga shumë vise e, ndër to, edhe nga Italia e Polonia, dy epikologë të njohur, prof. dr. Nikolla Skalldaferi (Nicola Scaldaferri) dhe prof. dr. Rigels Halili. Redaksia i ka renditur kumtesat për botim sipas këtyre fushave: histori, gjuhësi, hulumtime kërkimore-shkencore në Sanxhakun e Pazarit të Ri dhe në Universitetin e Harvardit, pasqyrime të hulumtimeve të dorëshkrimeve të epikës gojore shqiptare në fondet arkivore të Harvardit, si dhe disa të tjera.

Ky vëllim hapet me kumtesën e mbajtur nga Ma. Ismet Azizi, “*Sanxhaku i Pazarit të Ri në fokusin e historisë*”. Ai thekson që në fillim se Sanxhaku gjendet në qendër të Gadi-

shullit Ballkanik, ka popullsi shqiptare dhe shqiptare të boshnjakizuar, si dhe një pakicë të popullsisë sllave. Shumica kanë tradita të trashëguara nga lashtësia ilire-arbërore: të folmen, veshjen, doket, ritet, mitet, festat e motmotit, lojërat, vallet, këngët ku veçohen këngët e Eposit të Kreshnikëve dhe lahuta, që tashmë janë të njohura për opinionin botëror. Sanxhaku, vazhdon ai, sot u takon dy shteteve, Serbisë dhe Malit të Zi.

Pason kumtesa e prof. dr. Rexhep Doçit, ndër studiuesit tanë më të dalluar në fushën e onomastikës. Toponimet e atjeshme ilire, thotë ai, janë dëshmi e vijimësisë shqiptare në ato vise, kurse për ruajtjen e emrit ilir *Teutë*, oikonimi i sotëm *Tutin* dëshmon për një fortifikatë të atyshme. Por, gjendja e sotme, vazhdon ai, dëshmon se shumica e katundeve shqiptare të Rrafshnaltës së Peshterit janë shkomëtarizuar, sidomos në këto njëqind vitet e fundit, duke e humbur gjuhën e vet.

Kumtesa vijuese është e Prof. Dr. Rigels Halilit, epikolog nga Uni-

versiteti i Varshavës, i cili në fillim të këtij mijëvjeçari ka kryer hulumtime kërkimore-shkencore në Sanxhakun e Pazarit të Ri. Sanxhaku, pohon autori, mund të quhet një nga laboratorët më të gjallë të traditës gojore të këngës epiko-heroike, por mund të thuhet se tradita gojore sot në Sanxhak po shkon drejt humbjes tërësore, thotë ai, për shkak të ndryshimeve shoqërore, migracionit të brendshëm e të jashtëm, sidomos të zhvillimit të sistemit shkollor të kontrolluar nga instancat shtetërore.

Kumtesa tjetër është edhe ajo e Dr. Harun Crnovershaninit, kushtuar lahutarit Xhemajl Arnautoviqi, i lindur në vitin 1925 në fshatin Milijesh të Pribojit, që kishte botuar 11 libra dhe kishte shkruar 25 000 vargje, kurse boshnjakët në Suedi e kanë quajtur “Kalorës dhe Hero nga Sanxhaku i zemëruar”. Në vitet 1962-1965, ai kishte mbledhur edhe emrat e të vrarëve gjatë gjenocidit çetnik në Luftën e Dytë Botërore. Kështu, gjatë hulumtimit të hollësishëm, Xhemajl Arnautoviqi kishte mbledhur emrat dhe mbiemrat e 2 473 viktimave boshnjake, përfundon autori.

Kumtesa e studiuës arbëresh prof. dr. Nikolla Skalldaferi (Nicola Scaldaferrì) nga Universiteti i Milanos është rezultat i hulumtimit të tij kërkimor-shkencor në fondet arkivore të Universitetin të Harvardit, Koleksioni i Letërsisë Gojore të Millmen Perit (Milman Parry). Aty kemi, thotë ai, regjistrimin e parë të një kënge të tërë epike shqiptare dhe këngën më të gjatë shqipe, të dyja të pabotuara. E

para është kënduar nga Salih Uglla, ndërsa e dyta është e diktuar nga Adem Brahimi. Këngëtari Salih Uglla, një nga figurat qendrore, deri në moshën tridhjetë vjeçe këndoi vetëm në gjuhën shqipe. Ai përdori vetëm tri melodi të shkurtra, ose, më saktë, tri modele melodike. Këngët boshnjakisht të Salihit ofruan elemente të rëndësishme për zhvillimin e Teorisë së Formulës, pohon autori. Salih Uglla ishte i njohur edhe për studiuës të tjerë si Matija Murko dhe Alois Schmaus. Rasti i tij është shumë interesant dhe tregon se sa të ndërlikuara ishin lidhjet etnike dhe kulturore në atë zonë në atë kohë, përfundon autori.

Edhe kumtesa e prof. dr. Zymer U. Neziritështë, po ashtu, rezultat i kërkimeve të tij në Harvard, në Koleksionin e Letërsisë Gojore të Millmen Perit (Milman Parry), për lahutarët shqiptarë në Sanxhak: Salih Uglla, Avdo ose Avdullah Ferizi, Sulejman Makaj, Ali Fulani, Xhemajl Zogaj, Shaban Nuhoxha, si dhe Fatime Arifi, Ethem Hasani dhe Hamdi Murati. Salih Uglla e Avdo (Avdullah) Ferizi konsiderohen ndër homerët e fundit në Evropë. Lahutarët shqiptarë dygjuhësorë nuk janë sllavë. Ata deklarohen për përkatësinë shqiptare, kanë plisa të bardhë, mbiemra pa prapash-tesën boshnjake - viq, kanë leksik shqip në këngët boshnjakisht dhe kanë sintaksë të përmbysur boshnjake, prandaj duhet të rishikohet nga Harvardi edhe emërtimi i Koleksionit. Por, Lordi solli dëshmi shumë të rëndësishme në Harvard se këngët e kre-

shnikëve i këndojnë njësoj lahutarët shqiptarë të tëdyja besimeve, ndërsa Koleksioni i Perit mbetet kryevepër arkivore e eposeve heroike të Ballkanit dhe renditet ndër kryeveprat arkivore botërore të letërsisë gojore.

Në kreun *Pasqyrime* është renditur kumtesa e studiuesit dhe e kandidatit për doktor të Shkencave të Filologjisë, Mr. Fitim Veliu, për studimet e deritashme të Zymer Nezirit, në fondet arkivore të Universitetit të Harvardit, në vitet 2002, 2007 e në vijimësi. Ato, pohon ai, kanë si esencë trajtimin poetik të këngës epike në studimet e tij, në një rend substancial të kërkimit të këngëtarit, këngës dhe dëgjuesit (lexuesit), pra, një trinom që shenjon poetikën teorike dhe retorikën pragmatike, për ta dhënë eposin si dije e dëshmi dhe, në fund, si bindje, pra, retorikë e argumentuar, thotë autori. Në studimet e Z. Nezirit, në relacionin trinomik këngë, këngëtar dhe lexues, këto janë shenja themelore të epopesë si zhanër, thotë autori.

Në kreun *Të tjera*, Redaksia ka renditur dy kumtesa. E para ka të bëjë me shqyrtimin paralel të baladës boshnjake të vëllezërve Moriqi me vëllezërit Kastrati të Malësisë së Madhe, kumtesë kjo e studiuesit të njohur të folkloristikës, prof. dr. Adem Zejnullahu. Balada shqiptare e vëllezërve Kastrati dhe balada boshnjake e vëllezërve Moriqi, në rrafshin semantik, informativ e artistik janë krijime poetike që kanë pikëtakime të shumta, por kanë edhe karakteristika të veçanta kombëtare të shtresimeve të ndryshme etnopsikologjike, ambientore, thotë

autori. Kënga e vëllezërve Kastrati dhe balada e vëllezërve Moriqi kanë lindur dhe janë zhvilluar pavarësisht nga njëra-tjetra në kohë e hapësira të ndryshme, por edhe në rrethana të caktuara shoqërore, ekonomike, nacionale, sociale, politike, kulturologjike e historike, përfundon ai.

Mbledhësi i dalluar i folklorit shqiptar dhe botuesi i tij, sidomos i epikës heroike legjendare, studiues i njohur i disa fushave të albanologjisë, prof. asoc. dr. Shefqet Hoxha, ka këtë kumtesë për rapsodin e Eposit të Kreshnikëve, Jemin Zeneli, Ukperaj, bartësi më i dalluar (ndoshta jo më cilësori, por me një repertor të gjerë) në Hasin e Brijës, në gjysmën e dytë të shek. XX, pohon ai, që nuk dinte të lexonte dhe të shkruante, por që zotëronte talent natyral, mençuri, kujtesë të fortë dhe ndjeshmëri delikate. Ai ishte ndër këngëtarët e njohur në Has, nga i cili autori ka mbledhur dhjetëra këngë historike dhe këngë të Eposit të Kreshnikëve. Prej tij, autori ka shënuar dhe ka botuar 14 këngë të Eposit të Kreshnikëve dhe 28 këngë historike.

Në fund, duhet thënë, ky libër, i hartuar sipas standardeve të njohura shkencore, me rezyme edhe boshnjakisht e anglisht, është ndihmesë e vogël për krahinën e Sanxhakut të Pazarit të Ri, dikur pjesë e Kosovës, e sot e ndarë dysh ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi. Banorët e tij janë përfshirë në projekte shtetërore edhe për zhvendosje në Turqi, sidomos në kohën e Kralit, kur këtu bënin kërkime për Eposin e Kreshnikëve studiuesit e Universitetit të Harvardit dhe ku, për

fat të mirë, takojnë homerët e fundit të Evropës. Trajtimi i keq ndaj këtyre banorëve ka vazhduar edhe në kohën e Titos, prandaj sot jetojnë të zhvendosur në vende të ndryshme, një pjesë e madhe e tyre në Turqi, në Evropën Perëndimore e gjetiu. Ky libër, besoj se, sadopak, do t'u ndihmojë të gjithëve që ta njohin të kaluarën e vet të lavdishme të etnokulturës, që ruhet në fondet arkivore të Universitetit të Harvardit.

Zymer UJKAN NEZIRI